

Klan Kosova
Baton HAXHIU
Drejtor
Prishtinë

Rasti Nr. 2019/27
Ref:1907/935/KPM/mf

VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2019/27 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për Klan Kosova (Palë përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës përgjegjëse me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 ka iniciuar monitorimin ex officio të raportimit të aksionit të Policisë së Republikës së Kosovës në veriun e vendit të transmetuar në edicionet qendrore dhe informative në Palën përgjegjëse në datat 28 dhe 29 maj 2019. Fokus i monitorimit ishte mënyra e raportimit dhe paraqitja e arrestimit të të dyshuarve.
3. KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 7 qershor 2019 ka gjetur se Pala përgjegjëse gjatë raportimit të kësaj ngjarjeje ka transmetuar video në të cilat është bërë zbulimi dhe identifikimi i të dyshuarve, veprim ky i cili është në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.
4. KPM pas të gjeturave nga monitorimi, me datën 12 qershor 2019 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim për shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar të veprojë në pajtim me Kodin e Etikës KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës. Po ashtu, i ka ofruar mundësinë që brenda afatit prej tre (3) ditësh, pas pranimit të shkresës, të përgjigjet dhe të ofrojë sqarim në raport me shkeljet e gjetura.

5. KPM me datën 20 qershor 2019 ka pranuar një përgjigje nga Pala përgjegjëse përmes të cilës ata pretendojnë se me transmetimin e kronikës së aksionit të Policisë së Republikës së Kosovës në veriun e vendit nuk kanë bërë shkelje të Kodit të Etikës KKPM 2016/03, duke marr parasysh faktin se të gjithë ata janë zyrtarë shtetëror dhe janë arrestuar pikërisht me dyshimin se kanë bërë shkelje të detyrave zyrtare dhe se arsytet e ndalimit të tyre nuk kanë të bëjnë vetëm me jetën e tyre private, por me keqpërdorimin e posteve për të cilat paguhen nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Analiza ligjore

6. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, paragrafi 2 dhe 3, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Neni 7, paragrafi 2, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03, përcakton se:

“OSHM-të respektojnë të drejtën e individit që të konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia nga gjykata kompetente.”

Neni 7, paragrafi 3, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03, përcakton se:

“OSHM-të nuk duhet të transmetojnë materiale që identifikojnë personat e arrestuar apo ndaluar që sulmohen fizikisht apo verbalisht në mënyrë që i përul apo poshtëron ata.”

7. Komisioni gjatë monitorimit ka gjetur se Pala përgjegjëse gjatë raportimit të kësaj ngjarjeje ka transmetuar video, në të cilat është bërë zbulimi dhe identifikimi i të dyshuarve të arrestuar.
8. Komisioni duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka gjetur se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 7 paragrafi 2, dhe 3, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Vendim


9. Pala përgjegjëse sanksionohet me Vërejtje në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 7, paragrafi 2, dhe 3, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
10. Obligohet Pala përgjegjëse që në të ardhmen t'i kushtojë kujdesin e duhur mbrojtjes së identitetit dhe integritetit të personave të dyshuar në mënyrë që të veprojnë në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.

E drejta për ankesë

11. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i Vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa

bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.

12. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Muja FERATI
Kryetar



30.07.2019

Datë